



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERV. KOSOVO



Primitje / Biletë / Primitje / Pristite / Received / Delivery	23.06	2021	1	vitet years
Organ / Njësia Org / Jedinstvo Org / Unit	SKPM&DK	3293/2021		Sasia Kolicina Quantity
				1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.403/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.403/2021 të datës 11.05.2021 të parashtruar nga ankuesit

dhe të cilët me autorizim i përfaqëson Avokati me adresë Rr. "Mramori", Hajvali/Prishtinë, kundër organit të punësimit/Komunës së Shtimes, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 23.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.403/2021 e datës 11.05.2021 e parashtruar nga grup ankuesish te cilët me autorizim i përfaqëson Avokati

A r s y e t i m

Ankuesit dhe që të gjithë të punësuar në Komunën e Shtimes, me datë 11.05.2021 përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokatit kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 2317/2021 të regjistruar me numër A.nr.403/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin e pagave jubilarë dhe shujtave ditore, për vitin 2015, 2016, 2017 dhe 2018, sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 18.05.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Shtimes. Këshilli, me datë 03.06.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.


Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 2317/2021 të regjistruar me numër A.nr.403/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në kërkesat e nëpunësve civilë e datës 12.03.2021; Kërkesa e datës 06.04.2021; Autorizimi i datës 22.01.2021; Lista e pagës për Vërtetim i datës 20.01.2021; Kontrata e punës për Autorizim i datës 23.11.2020; Kopja e letër njoftimit e Lista e pagave për Vërtetimi i datës 18.11.2020; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit i datës 15.03.2019; Autorizim i datës 21.07.2020; Kopja e letër njoftimit e Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit i datës 15.03.2019; Lista e pagës për Vërtetim i datës 06.10.2020; Autorizim i datës 21.07.2020; Kopja e letër njoftimit e Vërtetim i datës 06.10.2020; Lista e pagave e Vërtetim i datës 06.10.2020; Shkresë emërim i datës 24.01.2011; Autorizim i datës 26.03.2020; Lista e pagave për Vërtetim i datës 22.02.2021; Kontrata e punës e si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 14/16.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesit dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesve, **është e pa bazuar, sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se të gjithë ankuesit janë të punësuar në Komunën e Shtimes. Të njëjtit, me datë 06.04.2021, përmes përfaqësuesit të autorizuar, i janë drejtuar me shkrim Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Shtimes, për kompensimin e pagave jubilarë dhe shujtës ditore për ditët e pranisë në punë. Komisioni Komunal për Shqyrtimin e Ankesave për Nëpunësit Publike në Komunën e Shtimes, lidhur me kërkesën e ankuesve, përmes përgjigjes me shkrim ka njoftuar përfaqësuesin e autorizuar të ankuesve se sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nëpunësit civil paraqesin ankesë drejtpërdrejtë në KPMSHCK për çdo veprim apo mosveprim që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil.

Pas këtij njoftimi, ankuesit, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 11.05.2021 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e pagave jubilarë dhe shujtave ditore, për vitin 2015, 2016, 2017 dhe 2018, sipas Kontratës se Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesve dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Marrëveshja



e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014, ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhe jo me shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017.

Bazuar në këtë konstatim, dhe në kuptim të nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, Kolegji konstaton se kërkesa e ankuesve për realizimin e kompensimit të pagave jubilarë dhe shujtave ditore për vitin 2015, 2016, 2017 dhe 2018 është parashkruar, kështu që pretendimi ankimor i ankuesve mbi këtë bazë ligjore është i pa bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.403/2021

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve Avokat
- Kryetarin të Komunës së Shtimes;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Shtimes; dhe
- Arkivët të KPMSHCK-së.